




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Nr.
No. 02-110/04-0029/16/25
Data
Data 21.07.2025

Procesverbal nga Diskutimi Publik për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba

Data: 14.07.2025

Ora: 14:00

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal të Komunës së Skenderajt

Të pranishëm: Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Ismet Aliu; Besnik Smakaj, kryesues; Amir Lushtaku, anëtar; Ilmi Kabashi, anëtar; Antigona Maliqi, anëtare; Dafina Shala, anëtare.

Besnik Smakaj: Përhëndetje për të gjithë, ju falënderoj për prezencën në diskutimin publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba. Kryetari ka formuar një Grup Punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba. Ky ndryshim vjen pas kërkesës nga organizatat e dala nga lufta dhe arsyeshmërisë së vlerësuar nga Kryetari i Komunës. Rregullorja për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba ndryshohet në nenin 5, pika 7, ku në kategoritë të cilat lirohen nga taksa për automjete përfshihen edhe familjet e dëshmorëve, familjet e viktimave civile dhe veteranët e luftës (personalisht), invalidët e luftës (personalisht). Në këtë rast, veteranët e luftës përfshihen si persona fizikë në rastin kur ai aplikon për pagesën e taksës për automjete, ndërsa familjet e dëshmorëve dhe familjet e viktimave civile janë të përfshira si familje të ngushta, pra prindërit, bashkëshortët dhe fëmijët e tyre. Kjo rregullore është në diskutim publik deri më datën 22 të këtij muaji. Nëse dikush ka ndonjë vërejtje apo sugjerim, mund të na kontaktoni edhe në email-et Besnik.smakaj@rks-gov.net dhe amir.lushtaku@rks-gov.net, por propozimet mund t'i jepni edhe sot në këtë diskutim publik.

Po e lexoj edhe nenin i cili ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 7 i nenit 5 të rregullores bazë, i cili formulohet si në vijim:

Nga taksa për automjete lirohen **familjet e dëshmorëve, familjet e viktimave civile, invalidët e luftës (personalisht), veteranët e luftës (personalisht)** dhe personat me aftësi të kufizuara.

Lirimi bëhet në bazë të prezantimit të dëshmisë (dokumenti bëhet fotokopje dhe i bashkëngjitet kërkesës) dhe në këto raste zyrtari për pagesa lëshon fletë-pagesa me vlerën zero (0), duke i'a bashkëngjitur dëshminë.

Në rregulloren e mëhershme, të liruar nga pagesa kanë qenë vetëm invalidët e luftës dhe personat me aftësi të kufizuara. Nëse ndokush ka ndonjë sugjerim apo propozim, le të marrë fjalën.

Luigj Azizaj: Faleminderit z. Smakaj, është i qëlluar ky ndryshim dhe plotësim.

Imer Loshi: Desha ta bëj një pyetje si propozim. Ky ndryshim dhe plotësim është shumë i arsyeshëm. Në rast se një veteran i ka dy automjete apo më shumë, a vlen për secilën lirim nga pagesa apo vetëm për një automjet?

Ismet Aliu: Faleminderit për pyetjen. Besniku e prezantoi qëllimin e këtij ndryshimi dhe plotësimi, dhe cilat kategori kanë qenë të lira. Kryetari ka propozuar që të ndryshohet dhe plotësohet kjo rregullore dhe të shtohen këto kategori për lirim nga kjo taksë. Kjo vlen për të gjitha automjetet që i ka një person, por duhet të jenë në pronësi personale. Ju keni të drejtë të jepni propozimet tua derisa është në konsultim publik dhe pastaj del në Kuvend Komunal.

Amir Lushtaku: Kjo Rregullore për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba është ndryshuar në vitin 2022 dhe është rregullorja më e rëndësishme që rregullon çështjen e pagesave të taksave, tarifave dhe gjobave. Në atë kohë e kemi mbajtur diskutimin publik, që ka qenë masiv, në Qendrën e Kulturës „Hasan Prishtina”. Por këtë nen, më vonë e kemi parë që është i mangët dhe kryetari e ka vlerësuar se duhet të përfshihen edhe këto kategori që i përmendëm. Ndryshimi dhe plotësimi bëhet vetëm në pikën për taksën për automjete, pjesët e tjera mbesin ashtu siç janë në rregulloren aktuale. Dikush tjetër? Nëse jo, deri më datën 22 është i hapur për vërejtje dhe sugjerime për këtë ndryshim dhe plotësim, dhe pastaj do t'i përcillet Kuvendit Komunal besoj në seancën e këtij muaji dhe do të hyjë në fuqi pasi të kthehet ligjshmëria nga MAPL.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen.

Procesmbajtësi: Ilmi Kabashi

